

PROCESVERBAL
nga seanca e 13-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 30.09.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: dr. Metodija Jançeski.

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: Toni Ajtovski, drejtues i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan.

Z. Petrushevski hapi seancën e 13-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.
2. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Petrushevski, shpjegoi se seancat publike në pajtim me Ligjin janë të parapara për arsyetimin e mediave. Në këtë drejtim, ai bëri të ditur se në seancë është i pranishëm edhe Toni Ajtovski drejtues i TV Kanal 8 nga Koçani, i cili do të japë shpjegim në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.

Z. Ajtovski shpjegoi se drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka dorëzuar Njoftim se nga data 30.09.2024 do të ndërpresë me transmetim të programit televiziv. Ai deklaroi se vendim për mbylljen e medias nuk ishte i lehtë, por duhej të

vendosnin kryesisht për shkak të gjendjes së rëndë financiare. Gjithashtu, si një nga arsytet ai përmendi dhe pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve ligjore të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, në pjesën e kushteve kadrovike gjegjësisht të punësimit të një numri të caktuar personash në televizion. Ai shpreson se ndoshta në të ardhmen gjendja ekonomike në vend do të përmirësohet dhe të hapen mundësi më të mira pune për mediat në nivel lokal dhe nivel rajonal. Në fund ai falenderoi për bashkëpunimin afatgjatë që ka pasur televizioni me drejtorin e Agjencisë, anëtarët e Këshillit dhe shërbimin profesional.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Zëvendës kryetari i Këshillit,
Selver AJDINI, d.v.**